



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:066443
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05447578

Ac.nr.4324/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Besnik Feka dhe Kujtim Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit RR.I., nga fshati S..... i P....., Komuna e Vushtrrisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.B., avokate nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, lidhur me kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, duke vendosur sipas ankesës të së paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtri, C.nr.375/2021, të datës 22.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtri, C.nr.375/2021, i datës 22.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

'I.APROVOHET si e bazuar, *kërkesëpadia e paditësit RR.I., nga fshati S..... i P....., Komuna e Vushtrrisë.*

II.DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, që paditësit t'i kompensoj shujtat ditore dhe atë për periudhën nga data 01.06.2020 e deri me datë 31.03.2021, për 147 ditë pune, t'ia paguaj shumën në vlerë prej 294.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 08.04.2021 e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

III.DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë, për padi shumë prej 104.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi shumë prej 21.00 euro, apo shumë e përgjithshme prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm''.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura përmes të autorizuarit të saj në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës në tërësi si të bazuar, ta anuloj aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta vendos në mënyrë meritore, ose ta prish dhe lëndën t'ia kthej në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Me përgjigje në ankesë e autorizuara e paditësit, ka propozuar që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi RR.I., ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë – Drejtoria për Arsim, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për 147 ditë pune, për periudhën kohore nga data 01.06.2020 e deri me datë 31.03.2021, nga 2 euro për një ditë pune, t'ia paguajë shumë prej 294.00€, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga ana tjetër e paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke propozuar që të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas pranimit të përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, e në pajtim me nenin 398 të LPK-së, jashtë shqyrtimi gjyqësor, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht vetëm sa i përket dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, ashtu që në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e nenit 35 paragrafin 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të së paditurës, se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) i LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për

themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune me të paditurën në vendin e punës mësimdhënës, fakt i vërtetuar nga kontrata e punës me numër protokollit 194-28 e datës 23.09.2015, po ashtu nuk ishte kontestues se paditësi për 147 ditë ishte në vendin e punës në periudhën kohore nga data 01.06.2020 e deri me datë 31.03.2021, fakt i vërtetuar nga vërtetimi i datës 24.03.2021, për të paditurën kontestuese ishte baza juridike e kërkesë padisë së paditësit.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Me nenin 35 paragrafin 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e obliguar të paditurën që paditësit në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për 147 ditë pune, t’ia paguajë shumën prej 294.00 €, me të drejtë është bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin e shpërbërimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, që rrjedhimisht nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurit lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 45 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo

vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Pretendimi ankimor i të paditurës *se sa i përket kërkesës së paditësit se e njëjta është vjetërsuar*, është i paqëndrueshëm për faktin se paditësi ka parashtruar padinë në gjykatë me datën 07.04.2021, bazuar në Marrëveshjen Kolektive e Arsimit, e cila ka hyrë në fuqi prej datës 22.01.2021, dhe kjo e drejtë paditësit i ka filluar prej kësaj date, mirëpo që gjykata e shkallës së parë gabimisht i është referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit që në emër të kompensimit të ushqimit ditor, si t'ia kompensojë shumën e aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme siç janë vërtetimet për ditët e pranisë në pune, nga të cilat edhe është vërtetuar saktësisht lartësia e kërkesëpadisë, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozita e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore. E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4324/2023, me datë 12.03.2024

Kryetare e Kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.